



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. 05-400-19781/15

Kaçanik, 30.06.2015

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITET
2016 – 2018

K a ç a n i k , Qershor 2015

Lista e shkurtesave :

AK	Administrata Komunale
BE	Bashkësia Evropiane
BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
BK	Buxheti i Komunës
BDMS	Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BPV	Bruto Produkti Vendor
DBK	Departamenti i Buxhetit Komunal
DEFZH	Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit
DAP	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
DAK	Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale
DSHPE	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës
DUKMM	Drejtoria e Urbanizmit, Katastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit
DBPZHR	Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FKBRK	Fondi i Komunave nga Buxheti i Republikës së Kosovës
GP	Granti i Përgjithshëm
GSA	Granti Specifik i Arsimit
GSSH	Granti Specifik i Shëndetësisë
THVK	Të Hyrat Vetjake Komunale
THV	Të Hyrat Vetjake
KASh	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KABK	Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale
KG	Komisioni i Granteve
KESH	Klasifikimi Ekonomik i Shpenzimeve
LFPL	Ligji i Financave të Pushtetit Lokal
LMFP	Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi
LVQL	Ligji i Vetëqeverisjes Lokale
MF	Ministria e Financave
PI	Plani i Integruar
PIP	Programi për Investime Publike
PPP	Partneriteti Privato Publik
PVP	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
QBB	Qarkorja e Brendshme Buxhetore
RGJB	Rishikimi Gjashtëmujor i Buxhetit
ZK	Zyra e Kryetarit
ZKK	Zyra e Kuvendit të Komunës
ZKF	Zyrtari Kryesor Financiar

PJESA E PARË

1. SHQYRTIMET HYRËSE

Me procedurat e hartimit të dokumentacioneve përcjellëse të Buxhetit Afatmesëm të Komunës për periudhën e viteve 2016-2018, Komuna zyrtarisht ka filluar qysh nga data 21 maj 2015, atëherë kur nga Ministria e Financave është pranuar Qarkorja buxhetore nr.2016/01 – Për Komunat.

Në aktivitetet tona gjatë përgatitjes dhe hartimit të Draft - Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës (KABK), përveç që jemi bazuar në Qarkoret buxhetore nr.2016/01– Për Komunat, gjithsesi jemi shërbyer edhe me projeksionet e dhëna me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016 -2018 në nivel të vendit, si dhe në dokumentin e rëndësishëm strategjik të komunës - draft Planin e Integruar për vitet 2013-2015.

Njëkohësisht, potencojmë se përveç tre (3) dokumenteve të sipërshënuara, në përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës, jemi bazuar edhe në legjislacionin përkatës nga kjo lëmi si, në Ligjin nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, në Ligji nr. 03/L-048 - Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, në Ligjin nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin nr.03/L-060– Për Kufijtë Administrativ Komunal.

Gjatë hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore të komunës 2016 – 2108, gjithnjë kemi pasur për bazë:

- vizionin dhe katër (4) prioritet e nivelit të lartë me Planin e Integruar të komunës për vitet 2013-2015,
- politikat dhe strategjit ekzistuese të komunës sipas dokumentacioneve zhvillimore,
- ndarjet buxhetore mbi bazën e buxhetimit të programeve dhe nënprogrameve buxhetore funksionale të komunës,
- planifikimi i bazuar në mundësitë reale të buxhetit të komunës,
- realizimi i objektivave programore, duke i respektuar procedurat më të avansuara – reformuese nga qeveria e vendit, të cilat janë në pajtueshmëri të plotë edhe me kërkesat dhe rekomandimet e Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN-në),

Vizioni dhe prioritetet e identifikuar me Planin e Integruar të komunës, pastaj instruksionet dhe udhëzimet e marrura nga niveli qendror, Kufijtë e financimit nga Grantet qeveritare prej Komisionit të Granteve, e në veçanti projeksionet në nivel të vendit e të prezentuara në KASH-in 2016-2018, me të madhe kanë ndihmuar procesit të hartimit të KABK-së 2016-2018, i cili dokument do të jetë bazë për komunën lidhur me procesin e mëtejshëm të zhvillimeve buxhetore deri në fazën e aprovimit të Buxhetit të komunës në Kuvend.

Po ashtu, ky draft i miratuar – KABK-ja, do të na shërbejë edhe si dokumentacion ndërlidhës për realizimin konkret të prioriteteve dhe nënprioriteteve (objektivave) të komunës për tre vitet e ardhshme buxhetore 2016-2018.

Në fund, potencojmë edhe këtë të dhënë, se KABK-ja dhe të gjitha dokumentacionet e tjera përcjellëse që do të pasojnë, do të jenë një bazë e mirë për Qeverinë komunale dhe për të

gjithë bartësit e programeve – nënprogramet buxhetore, për aktivitetet vijuese deri te përmbyllja e të gjitha fazave sipas kalendarit kohor të përcaktuar nga MF-ja.

2. KORNIZA AFATMESME E SHPENZIMEVE 2016-2018

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) paraqet prioritetet e Qeverisë me një qasje koherente, të koordinuar dhe të ndërlidhur funksionalisht me dokumentet strategjike dhe programore të Qeverisë. KASH-i mundëson buxhetimin e këtyre prioritetëve për periudhën afatmesme. Qeveria e Republikës së Kosovës ka synim parësor ndërtimin e një qeverisje efektive, kompetente dhe të përgjegjshme, drejt një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike dhe fuqizimit të mirëqenies sociale.

Këto prioritate për periudhën afatmesme 2016-2018 bazohen në Programin e Qeverisë 2015-2018, Programin Kombëtar për Reforma në Ekonomi 2015, dhe kërkesat në kuadër të procesit të integritetit Evropian, përkatësisht Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim. Deklarata e prioritetëve afatmesme është e orientuar drejt zhvillimit ekonomik, social dhe institucional të vendit. Rrjedhimisht, përmes kësaj Deklarate, Qeveria e Kosovës drejton procesin e zhvillimit të buxhetit për periudhën 2016-2018. Në këtë kontekst, KASH-i është hartuar në pajtueshmëri me zotimet e Qeverisë në raport me institucionet ndërkombëtare, brenda parametrave të lejueshëm me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi (LMFPP).

Në kuadër të prioritetëve të Qeverisë për të siguruar rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të punës, gjatë periudhës afatmesme 2016-2018, Qeveria do të vazhdojë zbatimin e reformave fiskale, luftimin e ekonomisë jo-formale duke siguruar një ambient më të favorshëm biznesor. Në anën tjetër, Qeveria synon vazhdimin e zbatimit të kontratës kolektive, duke paguar për përvojën e punës për nëpunësit që marrin paga nga buxheti i Kosovës, pagesën e sigurimeve shëndetësore, forcimin e rendit dhe sigurisë, mbështetjen e sektorit të bujqësisë, vazhdimin e financimit të skemave sociale dhe pensione, duke përfshirë skemat për ish të përndjekurit dhe të burgosurit politik, veteranët e luftës. Qeveria do të vazhdojë me investimet në infrastrukturën rrugore, **duke përfshirë ndërtimin e Rrugës 6 (rruga Prishtinë- Hani i Elezit)**. Gjithashtu, do të thellohen reformat në sektorë të caktuar, siç janë reforma strukturore në arsim, si dhe modernizimi dhe reformimi i administratës publike.

Në këtë kuadër, duke u bazuar në Programin e Qeverisë, prioritetet për periudhën afatmesme janë përmbledhur në pesë shtyllat e mëposhtme:

- ☐ Zhvillimi Ekonomik, Punësimi dhe Mirëqenia Sociale;
- ☐ Sundimi i ligjit dhe shteti ligjor;
- ☐ Arsimi, shkenca, kultura dhe zhvillimi rinor;
- ☐ Agjenda evropiane dhe politika e jashtme;
- ☐ Shëndetësia moderne.

2.1. Korniza Makro - Fiskale për vitet 2016 – 2018

Ekonomia botërore gjatë vitit 2014 u karakterizua me rimëkëmbje të ngadaltë, veçanërisht tek ekonomitë e avancuara të cilat po vazhdojnë të vuajnë nga nivele të larta të borxhit publik dhe atij privat. Edhe pse tregjet financiare ishin optimiste, investimet nuk kanë arritur nivelet e pritura, veçanërisht në ekonomitë e avancuara. Vlerësimet dhe pritjet ekonomike u mbështetën në supozimin se rritja botërore do të nxitet nga ekonomitë e avancuara si rezultat i masave të ndërmarra për konsolidim fiskal dhe politikës monetare të përshtatshme. Pavarësisht aktivitetit të dobësuar, fluksi i kapitalit për në tregjet në zhvillim vazhdon të jetë stabil, ku normat e këmbimit kanë luajtur rol stabilizues në disa raste.

Ndër ekonomitë e avancuara, EU-ja dhe Japonia presin rritje më të ngadaltë në krahasim me SHBA-të. Ndërkaq ndër ekonomitë në zhvillim pritet një rritje më e ngadaltë e Kinës dhe Brazilit. Për më tepër, është pritur që tensionet gjeopolitike (situata mes Rusisë-Ukrainës dhe konflikti në Lindjen e Mesme), edhe pse aktive ende në kuadër të regjioneve të tyre respektive, të ulen deri në këtë periudhë. Mirëpo ato vazhdojnë të jenë gjithnjë e më krcënuese për sigurinë e gjithmbarshme dhe posaçërisht për ngritje të pasigurisë ekonomike.

Zhvillimet ekonomike në perfundim të vitit 2014 dhe në pjesën e parë të vitit 2015 ndikuan që agjentët ekonomikë të ndryshojnë pritjet për ekonominë globale, zhvillime këto që ndikuan në rishikimin e parashikimeve të tyre zyrtare mbi nivelet e rritjes ekonomike. Rënia e çmimit të naftës (e nxitur nga ana e ofertës) pritet të shtyjë rritjen globale përgjatë dy viteve të ardhshme duke rritur fuqinë blerëse dhe kërkesën private tek vendet importuese të naftës. Kjo pritet të manifestohet më fuqishëm tek ekonomitë e avancuara, për shkak të transmetimit më të shpejtë të efektit të uljes së këtyre çmimeve tek konsumatorët/përdoruesit final, përderisa tek ekonomitë në zhvillim efektet pozitive në rritje ekonomike pritet të manifestohet më tepër përmes investimeve publike¹. Në anën tjetër, ballafaqimi me norma më të ulëta të rritjes ekonomike në krahasim me pritjet në shumë shtete (përveç SHBA-ve) mendohet që do të pritet me përshtatje të sjelljes nga ana e agjentëve ekonomikë, që do të manifestohej përmes rënies së investimeve. Një sjellje e tillë do të kundërvepronte me efektin e uljes së çmimit të derivateve. Kjo do të ndikonte që rënia e çmimit të naftës të mos shfrytëzohet në potencialin e plotë që paraqet, prandaj rritja ekonomike në shumë shtete për vitet në vijim është ulur në rishikimin e janar 2015, përveç në rastin e SHBA-ve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur normat e ri-shkuara të rritjes ekonomike sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar Nga tabela shohim rishikim të normës globale të rritjes ekonomike në 3.5% (nga 3.8%) për vitin 2015 dhe në 3.8% (nga 4%) për vitin 2016.

Tabela 2.1. Vlerësimet për rritjen ekonomike (në %)

	Parashikimi Tetor 2014				Rishikimi 2015		
	2013	2014	2015	2016	2014	2015	2016
BPV botërore	3.3	3.3	3.8	4.0	3.4	3.5	3.8
Ekonomitë e avancuara							
Eurozona	-0.4	0.8	1.3	1.7	0.9	1.5	1.7
Gjermania	0.5	1.4	1.5	1.8	1.6	1.6	1.7
Ekonomitë në zhvillim	4.7	4.4	5.0	5.2	4.6	4.3	4.7
Ekonomitë evropiane në zhvillim	2.8	2.7	2.9	3.3	2.8	2.9	3.2
Regjioni i Ballkanit							
Shqipëria	0.4	2.1	3.3	4.2	2.1	3.0	4.0
Maqedonia	2.9	3.4	3.6	3.9	3.8	3.8	3.9
Mali i Zi	3.5	2.3	3.4	3.3	1.1	4.7	3.5
Serbia	2.5	-0.5	1.0	1.5	-1.8	-0.5	1.5

Tabela 2.2: Të hyrat buxhetore dhe pjesëmarrja e tyre në BPV, në miliona euro

Pershkrimi	2013	2014	2015 Buxheti	2016 Proj.	2017 Proj.	2018 Proj.
Te hyrat e pergjithshme	1,329	1,345	1,587	1,588	1,607	1,625
si % e BPV-se	24.9	24.1	27.1	25.9	24.9	23.8
Te hyrat tatimore*	1,105	1,141	1,397	1,263	1,289	1,318
si % e BPV-se	20.7	20.5	23.8	20.6	20.0	19.4
Te hyrat jo-tatimore dhe vetanake	168.4	176.7	195.0	206.8	209.8	213.2
si % e BPV-se	3.2	3.2	3.3	3.4	3.3	3.1
Te hyrat e njehershme dhe mbeshtetja nga donatore	43.0	15.0	30.6	105.8	95.6	80.6
si % e BPV-se	0.8	0.3	0.5	1.7	1.5	1.2

Tabela 2.3: Struktura e shpenzimebe si % e PBV-së

Përshkrimi

	2013	2014	2015 si % e BPV-së	2016	2017	2018	2016-2018 Mesatare
Shp. e përgjith.	27.8	26.4	29.0	28.2	27.0	25.7	27.0
Rrjedhëse	17.8	18.9	20.9	20.4	19.4	18.5	19.4
Pagat dhe mëditjet	7.8	8.7	9.6	9.2	8.8	8.4	8.7
Mallrat dhe	4.0	3.7	3.8	3.6	3.4	3.3	3.3

shërbimet							
Subvencionet dhe transferet	5.9	6.5	7.5	7.7	7.4	7.0	7.4
Shpenzimet kapitale	9.9	7.4	7.8	7.6	7.3	7.0	7.3
Deficiti primar	-2.8	-2.3	-1.8	-2.3	-2.1	-1.9	-2.1
Deficiti i përgjithshëm (sipas rregullës fiskale)	-3.1	-2.2	-1.9	-2.0	-2.0	-2.0	-2.0

Në total, për periudhën 2016-2018, parashihet që arkëtimi kumulativ i të hyrave buxhetore të arrijë vlerën prej 4.74 miliardë euro, me 1.588 miliardë euro si mesatare vjetore. Pjesëmarrja e të hyrave në BPV përgjatë periudhës afat-mesme pritet të jetë mesatarisht 26%, me një pjesëmarrje mesatare të të hyrave tatimore në 20.6%.

Pjesëmarrja e të hyrave tatimore në BPV parashihet të ulet gradualisht në 19.4% deri më 2018, pasi që në periudhën afatmesme politika fiskale pritet të akomodojë dy marrëveshje për tregëti të lirë (me Turqinë dhe Bashkimin Evropian), si dhe të ofrojë lehtësira fiskale për stimulimin e sektorit privat përfshirë këtu lirimet e aprovuara doganore për inputet në prodhim, stimuj tatimor për zonat e lira ekonomike, si dhe stimuj për thithjen e investimeve të huaja direkte. Si rezultat, parashihet që si përqindje ndaj aktivitetit të përgjithshëm ekonomik (BPV-së) barra tatimore të jetë më e ultë.

2.3. Të Hyrat Sipas Burimit të Arkëtimit

Në fund të periudhës së parashikimit, **të hyrat vendore** pritet të arrijnë vlerën prej 384.6 milionë euro nga 345.6 milionë euro (përfshijë parashikimin për inkasimin e borxheve) sa është planifikuar për vitin 2015. Kjo rritje pritet të mbështetet kryesisht nga rritja e të hyrave nga TVSH-ja si rezultat i ndryshimeve të fundit në normën dhe pragun e TVSH-së si dhe parashikimi i rritjes së konsumit përgjatë kësaj periudhe. Të hyrat nga tatimi në korporata dhe tatimi i mbajtur në burim pritet të rriten me një rritëm më të përshpejtuar

- **Të hyrat doganore:** pritet të arrijnë vlerën prej 976 milionë euro në fund të periudhës së parashikimit. Të hyrat doganore parashihet të mbështeten kryesisht nga kërkesa e shtuar për importe megjithëse fillimi i implementimit të marrëveshjeve për tregti të lirë pritet të zvogëlojë efektin e rritjes së importit në të hyrat e mbledhura nga ky burim. Efekt negativ në të hyra parashihet të ketë edhe lirimi nga TVSH-ja i linjave të prodhimit dhe makinerive i paraparë me ndryshimin e fundit të ligjit mbi TVSH-në. Këto efekte direkte negative pritet që pjesërisht të kompensohen me të hyrat shtesë neto nga përshkallëzimi i TVSH-së. Andaj, të hyrat nga dogana pritet të vazhdojnë të dominohen nga të hyrat nga TVSH-ja, përdërisa të hyrat nga detyrimi doganor pritet që përgjatë periudhës së vërtetuar të ulen gradualisht. Burim i rëndësishëm i të hyrave doganore janë edhe të hyrat e mbledhura nga taksa e akcizës, të cilat parashihet të vazhdojnë të rriten si rezultat i rritjes së importit të mallrave që i

nënshtrohen kësaj takse si dhe i normave të ngritura së fundmi për disa produkte për të cilat aplikohet taksa e akcizës.

- **Të hyrat jo-tatimore, vetanake, dhe të hyrat tjera:** ndonëse me potencial të gjërë për rritje, sidomos në nivelin komunal, janë parashikuar të mbesin konstante në raport me BPV-në. Këtu vlen të ceket se rritja në vlerë nominale e kësaj kategorie e të hyrave mbështetet nga të hyrat vetanake të nivelit komunal të cilat pritet të rriten me një normë më të lartë si rrjedhojë e fillimit të implementimit të tatimit në tokë. Si e hyrë shtesë në këtë kategori të hyrash është paraparë edhe mbështetja direkte buxhetore nga Komisioni Evropian, të hyrat nga grantet e donatorëve dhe të hyrat nga programi G2G (Government to Government) të mbështetur nga USAID. Të hyrat nga tani reflektojnë parashikimet për eksploatimin e linjtit dhe minierave tjera nga bartësit e licencës dhe nuk reflekton ndryshim të normës së tantimës. Po ashtu, si e hyrë shtesë është paraparë edhe dividendat nga ndërmarrjet publike në vlerë prej 30 milionë euro.

Burimi: MF, Departamenti i Thesarit, Departamenti i Buxhetit dhe Kalkulimet e DPEP

3.MARRËDHËNIET FISKALE NDËRQEVERITARE DHE FINANCIMI KOMUNAL PËR VITIN 2016-2018 BRENDË KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE (KAB KOMUNALE)

3.1 Burimet e Financimit Komunal për vitin 2016-2018

Financimi komunal përfshinë: Grantin e përgjithshëm, Grantin specifik për Arsim dhe Grantin specifik për Shëndetësi, përfshirë financimin për shëndetësi sekondare, grantet për kompetencat e shtuara, projeksionet e të hyrave vetanake të komunave, transferet për kompetencat e shtuara dhe deleguara, grantet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Grantet bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive, duke ju dhënë kështu komunave pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e tyre.

Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opcion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në LMFPP të dakorduar me Misionin e FMN-së. Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifatat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Financimi komunal agregat për komuna për vitin 2016-2018 (mil. Euro):

Tabela: Korniza afatmesme e financimit komunal 2014-2018, mil. euro

Përshkrimi	2014	2015 Buxheti	2016 Parashikimi	2017 Parashikimi	2018 Parashikimi
1. Grantet qeveritare	319.52	339.17	338.32	340.90	343.97
Granti i përgjithshëm	137.57	145.76	134.91	137.49	140.56
Granti i përgjithshëm bazë	127.80				
Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL	9.77				
Granti specifik për shëndetësi	39.39	42.08	42.08	42.08	42.08
Granti specifik për arsim	142.56	151.33	161.33	161.33	161.33
Financimi bazë	142.22	143.89	150.08	150.08	150.08
Politikat e reja dhe ne vazhdim:	0.34	0.34			
Qendrat e ekselencës	0.34	0.34			
Kontigjenca nga Buxheti Qendror për financimin e rritjes së pagave 25%		10.00			
Amendamenti nga KBF (transferi nga Komunitat në MASHT -shkollat profesionale)		-2.90			
Përvoja e Punës			6.00	6.00	6.00
Sigurimet shëndetësore			5.25	5.25	5.25
2. Grantet për kompetencat e shtuara	1.85	2.60	2.60	2.60	2.60
Kujdesi shëndetësor dytësor	1.85	2.60	2.60	2.60	2.60
3. Transferi i Shërbimeve rezidenciale nga MPMS në Skenderaj dhe Graçanicë	0.24	0.24	0.24	0.24	0.24
Shërbimet rezidenciale	0.24	0.24	0.24	0.24	0.24
4. Të hyrat vetanake komunale	67.23	74.24	80.00	82.00	84.00
5. TOTAL FINANCIMI KOMUNAL	388.60	416.01	421.16	425.74	430.81

Tabela: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për periudhën 2016-2018 (mil. Euro)

Kriteret	Faktorët	2014	2015	2016	2017	2018
		Aktual	Buxheti	Vlerësimi	Vlerësimi	Vlerësimi
Shuma agregate	Të hyrat buxhetore (mil euro)	1,278.0	1,457.6	1,349.1	1,374.9	1,405.6
	10% e të hyrave buxhetore (mil euro)	127.80	145.76	134.91	137.49	140.56
Kosto shtesë nga Niveli Qendror	Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL	9.77				
E l e m e n t e t	Shuma Fikëse	3.63	3.63	3.63	3.63	3.63
	Popullsia	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021	1,780,021
	Parametri: 89% e shumës agregate	110.5	118.06	116.83	119.13	121.86
	Zona komunale (km2)	10,901	10,901	10,901	10,901	10,901
	Parametri: 6% e shumës agregate	7.45	7.9	7.87	8.03	8.21
	Komunitetet pakicë në komunë	107,926	107,926	107,926	107,926	107,926
	Parametri: 3% e shumës agregate	3.7	3.9	3.93	4.01	4.1
	Popullsia e komunave pakicë	62,031	62,031	62,031	62,031	62,031
	Parametri: 2% e shumës agregate	2.4	2.6	2.62	2.67	2.74
	Total granti i përgjithshëm	137.57	145.76	134.91	137.49	140.56

- Në vijim po japim shpërndarjen e grantit të përgjithshëm në bazë të formulës përkatëse qeveritare:

1. GRANTI I PËRGJITHSHËM:

GP. mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë buxhetore komunale, është mekanizëm për Sigurimin e barazisë ndërmjet komunave si dhe mundëson alokim adekuat të burimeve për komunitetet pakicë në komunat përkatëse.

Në bazë të kriterëve të formulës për alokim të grantit të përgjithshëm, granti i përgjithshëm për Komunën e Kaçanikut për periudhën 2016 – 2018 duket kështu:

Viti 2016:

Shuma fikse (140,000-1€) (33,409 banorë)	Shuma për popullsi (89%) (1.88%)	Shuma për madhësi gjeog. (6%) (1.94%)	Shuma për pop. pakicë (3%)	Shuma për komunitetet pakicë (2%)	Total Granti i Përgjithshëm
106,591 €	2,192,830 €	152,526 €	1,314 €	-	2,453,260 €

Viti 2017:

Shuma fikse (140,000-1€) (33,409 banorë)	Shuma për popullsi (89%) (1.88%)	Shuma për madhësi gjeog. (6%) (1.94%)	Shuma për pop. pakicë (3%)	Shuma për komunitetet pakicë (2%)	Total Granti i Përgjithshëm
106,591 €	2,235,927 €	155,523 €	1,339 €	-	2,499,381 €

Viti 2018:

Shuma fikse (140,000-1€) (33,409 banorë)	Shuma për popullsi (89%) (1.88%)	Shuma për madhësi gjeog. (6%) (1.94%)	Shuma për pop. pakicë (3%)	Shuma për komunitetet pakicë (2%)	Total Granti i Përgjithshëm
106,591 €	2,287,209 €	159,090 €	1,370 €	-	2,554,261 €

2. GRANTI SPECIFIK PËR ARSIM PARAUNIVERSITARË:

Granti specifik për arsim bazohet në parametrat/kriteret si vijon:

- Numri i nxënësve të regjistruar dhe të raportuar nga MASHT;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- Kritere tjera për të akomoduar politikat e arsimit për vitin 2016 (pagesa e përvojës së punës, sigurimet shëndetësorë);
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II
- Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT) ;
- Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT);
- Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë(roje) bazuar në Udhëzimin administrativ nr.18/2009 të MASHT;
- Shërbimi profesional (pedagog) nga 4 për 7 komunitat e mëdha dhe nga 2 për të gjitha komunitat tjera (bazuar në vendimet e mëparshme të Komisionit të Granteve).

Duke u bazuar në parametrat më lartë, për Komunën e Kaçanikut, shuma e ndarë e grantit Specifik për Arsim për vitin 2016 është **2,678,565.00€** (7,109 nxënës , 477 stafi total)

- Granti Specifik i Arsimit për vitet 2017-2018, bazuar në KASH-in e miratuar ne Qeveri do të jetë i njejtë sikurse i vitit bazik 2016

3. GRANTI SPECIFIK PËR SHËNDETËSI

Shpërndarja e grantit specifik për shëndetësi bazohet në formulën që merrë parasyshë numrin e vizitave për kokë banori shumëzuar me koston mesatare për vizitë dhe numrit të shërbimeve shumëzuar me koston mesatare për shërbime.

Kriteret e aplikuara për ndarjen e grantit specifik për shëndetësi për vitin 2016 janë si vijon:

2.5 vizita për kokë banori me një kosto prej 4 € për një vizitë,

3.5 shërbime për kokë banori me një kosto prej 3.89 € për një shërbim.

Popullsia :	2.5 vizita për kokë banori	4 Euro për vizitë	3.5 shërbime për kokë banori	3.89 euro për shërbime	Total Granti specifik për shëndetësi
a	(b=a*2.5)	(c=b*4€)	(d=a*3.5)	(e=d*3.89)	
33,409	83,523	334,090 €	116,932	455,799 €	789,889 €

- Granti Specifik i Shëndetësisë për vitet 2017-2018, bazuar në KASH-in e miratuar ne Qeveri do të jetë i njejtë sikurse i vitit bazik 2016.

PJESA E DYTË

1. VIZIONI DHE DEKLARATA E PRIORITETEVE TË KOMUNËS PËR VITET 2016-2018

Korniza Afatmesme e Buxhetit të Komunës për periudhën e viteve 2016-2018, paraqet një dokument ndërlidhës në mes të vizionit dhe prioriteteve të përcaktuara të komunës me parashikimet e projeksioneve të dhëna buxhetore për periudhën vijuese afatmesme.

Komuna në fund të vitit 2012, në bashkëpunim me ekspertët e Fondit për Bashkëpunim Evropian – Projekti i Binjakëzimit për komuna të fuqizuara ¹, kanë hartuar bashkarisht draf – Planin e Integruar për vitet 2013-2015, në të cilin dokument përveç përcaktimit të vizionit, janë identifikuar edhe katër (4) prioritet dhe nën-prioritetet (objektiva).

Plani i Integruar i komunës si dokument strategjik, është i përfshirë në këtë Kornizë Afatmesme të Buxhetit të komunës për vitet 2016-2018 dhe se roli e rëndësia e tij në hartimin e këtij drafti zhvillimor është thelbësore.

Vizioni dhe deklarata e prioriteteve të komunës mbi bazën e Planit të Integruar, si pjesë përbërëse e Kornizës Afatmesme të Buxhetit të Komunës për 2016-2018, kanë ndihmuar dukshëm në fokusimin tonë në sferën e planifikimit, duke u sigurua një buxhetim sa më i mirë dhe garancinet që në të ardhmën të kemi një process sa më efikas në menaxhimin dhe operimin me mjete buxhetore për çdo viti fiskal.

Në Planin e Integruar, të gjitha prioritetet e komunës janë të përcaktuara dhe të orientuara në drejtim:

- të sigurimit të një ekonomie të qëndrueshme lokale, në vazhdimin e ndërtimit të infrastrukturës publike,
- në zhvillimin e diversitetit dhe prodhimit bujqësor, si dhe në mbrojtjen e mjedisit,
- në krijimin e komuniteteve të fuqishme dhe aktive,
- në zhvillimin e një administrate më efikase, efektive dhe profesionale.

Për të realizuar këto prioritate, komuna do të vazhdojë të bëjë financimin brenda kornizës buxhetore për tre vitet e ardhshme këto sektorë funksional në nivel të komunës si, në infrastrukturë publike, në bujqësi, në sektorët e arsimit, në shëndetësi dhe mirëqenjes sociale dhe në atë të administratës publike.

Për realizimin e këtyre prioriteteve dhe objektivave janë parashikuar mjete buxhetore dhe se sipas parashikimeve të bëra, kostoja e tyre është e përballueshme sespse në vitet vijuese 2015-2017, buxheti i komunës do të shënon trende të rritjes në raport me vitet paraprake.

Në tre vitet e ardhshme, rëndësi e posaçme ido t'i jepet ndarjeve buxhetore te kategoria e investimeve kapitale, për të cilën kategori ekonomike të shpenzimeve në total do të jetë shuma në lartësi prej **3,399,916 €**.

¹ Projekt i menaxhuar nga Zyra e Bashkësisë Evropiane (BE) në Kosovë

2. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2016 - 2018

Korniza fiskale komunale apo Korniza e të hyrave komunale përfshinë pjesën e buxhetit komunal nga aspekti i parashikimit të të hyrave të përgjithshme komunale për sigurimin e mjeteve për financimin e shpenzimeve të komunës për periudhën e viteve 2016-2018.

Projeksionet në kornizën fiskale komunale , janë të bazuara mbi bazën reale të komunës dhe në përputhshmëri **jo të plotë** me kufijtë buxhetor me Qarkoren Buxhetore nr.2016/01 – Për Komunitet dhe me parashikimet e miratuara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2015-2017, në nivel të vendit.

Bazuar në të dhënat e Qarkores Buxhetore 01/2016 total financimi komunal për vitin 2016, Komuniteti do të mbështetet me Grant qeveritar në shumë prej: **5,921,714 €**, ndërsa nga të hyrat vetjake komunale do kemi një inkasim të parashikuar në shumë prej **709,672 €** apo një buxhet në total prej **6,631,386 €**.

Kur jemi të shumta e caktuar e financimit për komunitetin e Kaçanikut, grantet qeveritare për vitin 2016 janë zvogluar në krahasim me vitin 2015 në shumë prej 240,963 euro.

Megjithatë që nga muaji Prill dhe Maj i vitit 2015 me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka filluar të aplikohet pagesa e përvojës së punës për të gjithë ata që marrin paga nga buxheti i RKS dhe se duke filluar nga viti 2016 do të paguhet edhe kontributi për sigurime shëndetësore prej 7% (50% punëdhënësi) , kostoja e pagave do të rritet edhe për 496,765 euro.

Nga kjo që u cek më lartë del se zvoglimi i grantit prej 240,963 euro dhe rritja e kostos së pagave prej 496,765 euro, që në shumë totale arrihet, ka kushtëzuar që ne të qasemi hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale me një kërkesë për rritje të financimit të granteve shtesë dhe atë :

Granti i përgjithshëm prej 161,887 euro dhe

Granti specifik i arsimit prej 253,435 euro.

Gjithsej kërkesa për rritje të granteve në shumë prej 415,322 euro është kërkuar duke u bazuar se rritja e kostos së pagave të Administratës komunale nuk është kalkuluar fare për vitin 2016 dhe se kalkulimi i kostos shtesë të Arsimit për 478 punëtor është më i ultë për 253,435 euro.

Këto të dhëna na kanë shtyrë që ne të bëjmë të gjitha llogaritë me një financim vjetor prej 7,046,708 euro.

Tab: Burimet e financimit sipas Qarkores buxhetore 2016/01 dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike:

Burimet e financimit:

BURIMET E FINANCIMIT	VITI: 2015	VITI: 2016	VITI: 2017	VITI: 2018	GJITHSEJ: 2016-2018	DIFERENCA: 2016/2015(€)
GRANTI I PËRGJITHSHËM	2,647,217	2,453,260	2,499,381	2,554,261	7,506,902	(193,957.00)
GRANTI S. PËR ARSIM	2,725,571	2,678,565	2,678,565	2,678,565	8,035,695	(47,006.00)
GRANTI S. PËR SHËNDETËSI	789,889	789,889	789,889	789,889	2,369,667	-
TOTAL FINANCIMI QE VERITARË	6,162,677	5,921,714	5,967,835	6,022,715	17,912,264	(240,963.00)
TË HYRAT VETANAKE	695,757	709,672	723,865	738,342	2,171,879	13,915.00
TOTAL BUXHETI:	6,858,434	6,631,386	6,691,700	6,761,057	20,084,143	(227,048.00)

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike:

PAGA DHE MEDITJE	4,550,000	5,046,765	5,046,765	5,046,765	15,140,295	496,765
MALLRA & SHËRBIME	459,982	459,982	474,982	489,982	1,424,295	-
SHPENZIME KOMUNALE	141,000	141,000	141,000	146,000	428,000	-
SUBVENCIONE & TRANSFERE	248,989	248,989	248,989	248,989	746,967	-
INVESTIME KAPITALE	1,458,463	1,149,972	1,134,972	1,114,972	3,399,916	(308,491)
GJITHSEJ:	6,858,434	7,046,708	7,046,708	7,046,708	21,140,124	188,274
DEFICITI: Total buxheti minus total shpenzimi)	-	(415,322)	(355,008)	(285,651)	(1,055,981)	

Nën rrethanat kur grantet qeveritare ngelin të njëjta ashtu siq janë përcaktuar me QB 2016/01 ,atëherë në bazë të të gjitha analizave të bëra mundësia për kursime në pesë kategoritë ekonomike është vetëm te investimet kapitale dhe se ato duhet zbritur prej 1,149,972 euro në 734,650 euro.

Krahasuar me buxhetin e aprovuar për këtë kategori ekonomike të shpenzimeve në vitin 2015 e që është në shumë prej 1,458,463 euro ato do të zvogloheshin në vitin 2016 në shumë prej 720,735 euro apo pëgjysmimi i tyre.

Kërkesa për mjete plotësuese përveq asaj që është theksuar më lartë ,duke pas për bazë edhe zbatimin e politikave dhe stabilitetin makro fiskal në nivele vendi, nuk ka përfshirë edhe mos financimin prej grantit specifik të arsimit shpenzimet për mallëra dhe shërbime ,shpenzimet komunale dhe grantet e vogla për investime kapitale.

Sipas projeksioneve të dhëna deri në fund të vitit 2018, buxheti i komunës do të shënoj rritje të vazhdueshme vetëm te granti i përgjithshëm ndërsa grantet specifike do të ngelin të njëjta.

Ndërsa, **Të hyrat vetjake komunale (THVK)** në vitin pauses 2016 parashikohen të jenë në lartësi prej 709,672 ose një rritje për 2 % në raport me vitin 2015 (695,757 €) . Për vitin e fundit 2018, projeksionet e THVK janë në shumë prej 738 ,342 duke u projektuar një rritje prej 2 % në krahasim me vitin 2015.

2.1. Perspektiva e Politikave Fiskale Komunale

Në hartimin e perspektivës së politikave fiskale komunale jemi bazuar në informatat dhe analizat e KASh-it 2016-2018, në të cilin dokument projeksionet makro-fiskale parashohin një përmirësim të konsiderueshëm në vjeljen e të hyrave vetjake komunale (THVK), në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve të parasë publike, në zbatimin e kursimeve buxhetore, etj.

Financimi komunal nga të hyrat vetjake komunale për vitin 2016, të parashikuar në KAB Komunal 2016-2018, bazohet në dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Të hyrat vetjake komunale për vitin 2016 dhe projeksionet për vitet 2016-2018, përfshijnë të hyrat e planifikuara nga vetë komunat.

Sipas rekomandimeve të Misionit të FMN-së dhe të aprovuara nga Qeveria e vendit, komunat do të kenë fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2016, duke përjashtuar vetëm kategorinë për Paga dhe Mëditje.

Tabela – 4. Projeksionet e të hyrave vetanake nga Komunat për vitin 2014-2018

Projeksionet	2014	2015	2016	2017	2018
2014-2018	67.23	74.24	80.00	82.00	84.00

Financimi komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake komunale për vitin 2016 si dhe vlerësimet për vitin 2017-2018, si pjesë integrale e KASH-it 2016-2018

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale parimisht ofron deklarin e prioriteteve strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare dhe prezanton shumat agregate të granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin fiskal 2015 si dhe parashikimin afatmesëm 2016-2018 në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale si pjesë integrale e KASH-it 2016-2018.

Nga aspekti i kornizës së re ligjore për vitet 2009-2016, sistemi i financimit komunal ka pësuar reforma progresive përkatësisht ndryshime të mëdha në vijën horizontale dhe vertikale të financimit. Parimet, kriteret dhe formulat bazë të zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2016, si dhe pjesëmarrja e buxhetit komunal në Buxhetin e Republikës së Kosovës, janë strukturuar në linjë me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) duke respektuar kalendarin buxhetor të përcaktuar me LMFPF.

Komisioni i Granteve me datë 21 maj 2015 ka aprovuar grantet qeveritare dhe projeksionet e të hyrave vetanake sipas komunave në periudhën afatmesme, të bazuar në propozim-grantet specifike nga ministrinë e linjës MASHT dhe MSH, duke marrë për bazë aspektet në vijim:

- **Respektimi dhe zbatimi i parimeve të përgjithshme të përcaktuara në LFPL;**
- **Analizat e standardeve sektoriale të ofruara nga ministrinë përgjegjëse për arsim dhe shëndetësi;**
- **Formulat shtetërore për arsimin parauniversitar dhe shëndetësinë primare, për alokimin e granteve specifike në arsim dhe shëndetësi sipas komunave;**
- **Korniza makro-fiskale si bazë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, në kuadër të prioriteteve qeveritare.**

2.2. Parashikimi i Të Hyrave Buxhetore Komunale

Me parashikimet e dhëna për vitin 2015 dhe projeksionet indikative për vitet 2016-2018, të hyrat buxhetore komunale në masë monetare do të shënojnë trende të rritje permanente prej vitit në vit, me një dominim të vazhdueshëm të financimit nga Granti qeveritar (Fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës – Fondi i Komunave).

Tabela -5. Të hyrat e gjithëmbarshme buxhetore komunale për periudhën e viteve 2016 – 2018

BURIMET E TË HYRAVE:	Grantet dhe të Hyrat vetjake (THVK 2015)	Grantet dhe të Hyrat vetjake (THVK 2016)	Grantet dhe të Hyrat vetjake (THVK 2017)	Grantet dhe të Hyrat vetjake (THVK 2018)
GRANTI I PËRGJITHSHËM	2,647,217	2,453,260	2,499,381	2,554,261
GRANTI SPECIFIK PËR ARSIM	2,725,571	2,678,565	2,678,565	2,678,565
GRANTI SPECIFIK PËR SHËNDETËSI	789,889	789,889	789,889	789,889
TOTAL FINANCIMI QEVERITARË	6,162,677	5,921,714	5,967,835	6,022,715
TË HYRAT VETANAKE	695,757	709,672	723,865	738,342
TOTAL BUXHETI:	6,858,434	6,631,386	6,691,700	6,761,057

Duke u bazuar në trendet makro-ekonomike dhe projeksionet e dhëna në nivel të vendit dhe bazës së të dhënave numerike në vlerësimet e hershme buxhetore për periudhën 2016-2018, Buxheti i i komunës ka shënuar trende të rënies për 240,963 euro në krahasim me vitin 2015 të grantet qeveritare ndërsa rritje prej 2 % të të hyrave komunale.

Në vitin e parë buxhetor 2016 sipas këtyre parametrave, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve: pjesëmarrja me **89.30% nga të hyrat nga Granti qeveritar** dhe **10.70% nga Të Hyrat Vetjake Komunale** (do theksuar se në vitin 2015, ky raport ishte në proporcion 89% ndaj 11%, në favor të financimit nga Granti qeveritar).

Shikuar sipas viteve dhe strukturës së burimeve të mjeteve, në vazhdim prezantojmë këtë pasqyrë tabelare:

Nr.	Përshkrimi	Buxheti aktual 2015	Plani 2016	Vlerësimi 2017	Vlerësimi 2018
a	b		c	d	e
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	6,858,434	6,631,386	6,691,700	6,761,057
1.1	TË HYRAT VETANAKE	695,757	709,672	723,865	738,342
1.1.1	Tatimi në pronë	265,850	265,850	271,500	272,922
1.1.2	Taksat komunale	205,500	219,415	224,240	237,295
1.1.2.1	Licencat dhe lejet	12,500	12,500	13,000	13,000
1.1.2.2	Çertifikatat dhe dokumentet zyrtare	51,000	51,000	51,500	51,500
1.1.2.3	Taksat e regj.pajisjeve motorike	51,000	51,000	52,210	52,210
1.1.2.4	Lejet për ndërtesa	32,000	45,915	47,530	60,585
1.1.2.5	Taksat tjera komunale	59,000	59,000	60,000	60,000
1.1.3	Ngarkesat komunale	224,407	224,407	189,545	189,545
1.1.3.1	Ngarkesat regullatore	40,157	40,157	40,735	40,735
1.1.3.2	Të hyrat nga qiraja	25,000	25,000	25,000	25,000
1.1.3.3	Bashkë-pagesat për arsim	35,450	35,450	36,510	36,510
1.1.3.4	Bashkë-pagesat për shëndetësi	18,000	18,000	19,300	19,300
1.1.3.5	Ngarkesat tjera komunale (gjobat)	68,800	68,800	68,000	68,000
1.1.4	Të hyrat tjera	37,000	37,000	38,580	38,580
1.2	TRANSFERET QEVERTARE	6,162,677	5,921,714	5,967,835	6,022,715
1.2.1	Granti i Përgjithshëm	2,647,217	2,453,260	2,499,381	2,554,261
1.2.2	Granti specifik për arsim	2,725,571	2,678,565	2,678,565	2,678,565
1.2.3	Granti specifik për shëndetësi	789,889	789,889	789,889	789,889

Transferet qeveritare sipas kufijëve fillestar të Komisionit të granteve, për vitin 2016 do të jetë në lartësi prej 5,921,714 € dhe me këtë pjesëmarrje strukturale:

- **Granti i Përgjithshëm me 41,43% ;**
- **Granti Specifik për Arsim, me 45,23% ; dhe**
- **Granti Specifik për Shëndetësi, me 13,34%;**

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullorës së Tatimit në Pronë si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në Pronë, si gjenerator kryesor i të hyrave vetjake komunale (THVK), e që këtë lloj të hyre komuna pas grumbullimit duhet ekskluzivisht të shpenzoj vetëm për qëllime të realizimit të projekteve kapitale si, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellëse, kanalizime dhe investime e tjera, që thenë ndryshe këto mjete pas inkasimit menjëherë iu rikthehen qytetarëve apo tatimpaguesëve përmes formës së investimeve të destinuara për ngritjen e infrastrukturës komunale dhe mirëqenjes sociale.

Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:

- Tatimi në Pronë,
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë së biznesit (me pakon lehtësuese fiskale të miratuar në fillim të vitit 2015, të gjitha bizneset ekzistuese dhe ato fillestare janë të liruar nga pagesa duke i përjashtuar disa biznese nga kjo pako: si bankat komerciale, lokalet e lojërave të fatit, , bastoret, ndërmarrjet publike, etj.)
- Taksat për leje të ndërtimit,
- Taksa për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në pronë të komunës,
- Taksa për regjistrimin automjeteve motorike,
- Taksat administrative komunale (taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si, certifikatat e lindjes, martesës, shtetësisë etj.),
- Bashkë-pagesat në arsim,
- Bashkë-pagesat në shëndetësi, dhe
- Të hyra tjera (gjërat direkte dhe indirekte).

Përveç të hyrave nga Tatimi në Pronë, kemi edhe taksat tjera komunale të cilat kontribuojnë dukshëm në krijimin e THVK, si taksa për regjistrimin e automjeteve motorike, taksat për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në pronë të komunës, taksa për lejet e ndërtimit, etj.

Po ashtu, taksa komunale për leje ndërtimi është gjithashtu një kategori mjaftë e rëndësishme në krijimin e të hyrave komunale, për të cilën në tre vitet në vazhdim 2016-2018, do të zbatohen ndryshime pozitive ligjore duke përfshirë taksat për legalizimin e afro 7.000 objekteve që duhet pajisur me leje ndërtimi.

Me qëllim të rritjes së të hyrave vetjake komunale (THVK-ve) për periudhën e ardhshme buxhetore 2016-2018, komuna duhet gjithësesi të ndryshoj efikasitetin e punës në teren përmes shërbimve të inspeksioneve.

Duke u bazuar në të dhënat e prezentuara në Tabelën 6 – Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal, THVK për vitin aktual buxhetor 2015 janë të planifikuara në shumë prej 695,757 € , ndërkaj për vitet vijuese 2016-2018, përkatësisht në vitin e parë të planifikimit afatmesëm 2016, parashikohen që THVK-të të jenë në masë prej **709,672 €** ose një rritje e maturë prej **2 %** raport me 2015, pastaj në vitin 2017 dhe 2018 një rritje progresive prej 2% në vit.

Nëse i shikojmë të hyrat sipas llojit, lirshëm mund të konstatohet se në të gjitha vitet buxhetore 2016-2018, sikundër edhe në vitet paraprake, kemi një dominim të bindshëm të të hyrave nga Tatimi në Pronë me përafërsisht **37%**, i cili lloj i të hyrave komunale paraqet burimin kryesorë në krijimin e THVK të komunës (shih Tabelën - 6).

Mbështetur në të dhënat e pasqyruara në tabelarë dhe nga e gjithë kjo që u potencua, mund të konstatohet se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale për periudhën e ardhshme afatmesme 2016-2019, krahas varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga alokimet e Granteve qeveritare, gjithësesi do të jemi të varur edhe nga shkalla e realizimit të të hyrave direkte komunale, e që këto të fundit kanë ndikim edhe në shkallën e ekzekutimit të investimeve kapitale, të cilat do të financohen nga ky burim i të hyrave.

3. KORNIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE

3.1. Shpenzimet buxhetore sipas programeve buxhetore dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KAB Komunale për 2016-2018, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës së re buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës.

Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore, janë të bazuara në politikat dhe prioritet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Nisur nga katër (4) prioritetet tona strategjike për vitet 2016-2018, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimi i kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si, të administratën publike, arsimit dhe shëndetësisë me mirëqenje sociale. Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2016-2018, duke u krijuar një konsum investiv me një pjesmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës prej 16 % në vitet 2016-2018. Në sferën e realizimit të projekteve kapitale , rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit me donatorët për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike, si dhe realizimin e projekteve kapitale me koncesione dhe partneritet publiko-privat (PPP).

Tabela – 7. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve / nënprogrameve buxhetore – Viti 2015

Kodi	Kodi		2015					
Progr.	Nën-PB	Programet / Nënprogramet	Paga/Mëditje	Mallra / Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej
160		Zyra e Kryetarit	106,329	37,045	-	65,000	788,463	996,836
163		Administrata dhe Personeli	132,099	39,000	30,743	-	30,000	222,446
	16328	Administrata	126,225	37,500	30,473	-	30,000	224,468
	16528	Cështjet gjinore	5,874	1,500	-	-	-	7,734
169		Zyra e Kuvendit	88,577	6,000	-	-	-	94,577
175		Buxheti dhe Financat	84,615	5,600	-	-	-	90,215
180		Shërbimet Publike dhe Emergjenca	153,854	86,800	38,007		105,000	383,661
	18028	Infrastruktura rrugore	47,197	76,800	36,007		105,000	265,004
	18432	Zjarrfikësit dhe Inspek.	106,657	10,000	2,000			118,657
195		Zyra Komunale për Komunitete	7,338	2,000	-	-	-	9,338
470		Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	67,749	16,000	-	70,000	50,000	203,749
	47028	Bujqësia	25,207	8,000	-	70,000	50,000	153,207
	47108	Pylltaria dhe Inspek.	42,542	8,000	-			50,542
660		Planifikimi Urban dhe Mjedi	80,270	6,000	-		175,000	261,270
730		Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	664,284	99,537	23,950	5,000	160,000	950,771
	73037	Administrata	19,527	1,200	-			20,727
	74700	Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Primar	610,444	95,337	18,950		160,000	884,731
	75635	Shërbimet Sociale	38,227	3,000	5,000	5,000		51,227
920		Arsimi dhe Shkenca	3,160,972	162,000	48,300	108,989	150,000	3,630,261
	92140	Administrata	91,477	24,000	7,500	108,989	150,000	381,966
	92750	Arsimi Parashkollor	58,015	10,000	4,300	-	-	72,315
	93810	Arsimi Fillor	2,364,833	92,000	24,500	-	-	2,481,333
	95010	Arsimi i Mesëm	646,647	36,000	12,000	-	-	694,647
Gjithsej :			4,550,000	459,982	141,000	248,989	1,458,463	6,858,434

Tabela – 8. Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve / nënprogrameve buxhetore – Viti 2016

Kodi	Kodi		2016					
Progr.	Nën-PB	Programet / Nënprogramet	Paga/Mëditje	Mallra / Shërbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej
160		Zyra e Kryetarit	124,939	37,045	0	65,000	0	226,984
163		Administrata dhe Personeli	149,495	39,000	30,743	0	17,000	236,238
	16328	Administrata	143,141	37,500	30,743	0	17,000	228,384
	16528	Çështjet gjinore	6,353	1,500	0	0	0	7,835
169		Zyra e Kuvendit	87,926	6,000	0	0	0	93,926
175		Buxheti dhe Financat	100,463	5,600	0	0	242,972	349,035
180		Shërbimet Publike dhe Emergjencia	184,680	86,800	38,007	0	585,000	894,487
	18028	Infrastruktura rrugore	69,377	76,800	36,007	0	585,000	767,184
	18432	Zjarrfikësit dhe Inspek.	115,303	10,000	2,000	0	0	127,303
195		Zyra Komunale për Komunitete	8,121	2,000	0	0	0	10,121
470		Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	76,521	16,000	0	70,000	50,000	212,521
	47028	Bujqësia	29,124	8,000	0	70,000	50,000	157,303
	47108	Pylltaria dhe Inspek.	48,194	8,000	0	0	0	56,194
660		Planifikimi Urban dhe Mjedis	93,218	6,000	0	0	35,000	134,218
730		Shëndetësia dhe Mirëqenja Sociale	772,315	99,537	23,950	5,000	15,000	915,802
	73037	Administrata	21,421	1,200	0	0	0	22,621
	74700	Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Primar	702,914	95,337	18,950	0	15,000	832,201
	75635	Shërbimet Sociale	47,980	3,000	5,000	5,000	0	60,980
920		Arsimi dhe Shkenca	3,448,291	162,000	48,300	108,898	205,000	3,972,580
	92140	Administrata	105,320	24,000	7,500	108,989	205,000	450,809
	92750	Arsimi Parashkollor	69,599	10,000	4,300	0	0	83,899
	93810	Arsimi Fillor	2,559,607	92,000	24,500	0	0	2,676,107
	95010	Arsimi i Mesëm	713,765	36,000	12,000	0	0	761,765
			5,046,765	459,982	141,000	248,989	1,149,972	7,046,708

Tabela – 9. Shpenzimet komunale parashikimet afatmesme për periudhën 2017-2018:													
Programet/ Nënprogramet	2017						2018						
	Paga/	Mallra/	Komunalitë	Subvencione	Kapitale	Gjithsej	Paga/	Mallra/	Komunalitë	Subvencione	Kapitale	Gjithsej	
	Mëditje	Shërbime					Mëditje	Shërbime					
Zyra e Kryetarit	124,939	37,045	0	65,000	0	226,984	124,939	37,045	0	65,000	0	226,984	1,156,308
Administrata dhe Personeli	149,495	39,000	30,743	0	15,000	234,237	149,495	39,000	30,743	0	15,000	234,237	197,642
Administrata	143,141	37,500	30,743	0	15,000	226,384	143,141	37,500	30,743	0	15,000	226,384	189,867
Çështjet gjinore	6,353	1,500	0	0	0	7,853	6,353	1,500	0	0	0	7,853	7,775
Zyra e Kuvendit	87,926	6,000	0	0	0	93,926	87,926	6,000	0	0	0	93,926	90,239
